

## **MERITA SAUKU BRUCI**

### **ETËHEM HAXHIADEMI DHE ANDON Z. ÇAJUPI: DY FATE BOTIMI**

Në këtë kumtesë kemi synuar t'i shohim veprat e Etëhem Haxhiademit dhe të Andon Zako Çajupit në një këndvështrim thjesht filologjik. Kemi dashur të vëzhgojmë sa korrekt është një botim, duke u përpjekur të ndajmë mendimin dhe fjalët autentike të autorit nga ndryshimet që mund të ketë pësuar gjatë transmetimeve teksti për të dy autorët e marrë në shqyrtim. Pra për ne objekt i shqyrtimit nuk është libri por teksti i pasqyruar në të, nisur nga fakti që nga momenti që ai bëhet publik, teksti bëhet subjekt i një transmetimi intensiv. Për të realizuar më së miri këtë synim na është dashur të mbledhim, të shqyrtojmë e të përqasim të gjitha dëshmitë e tekstit që ekzistojnë për të dy veprat e përzgjedhura prej nesh. Saktësojmë që zgjedhja jonë përfshin dy vepra, nga një për secilin autor, nisur nga fakti se numri i botimeve nga shtëpi a ente botuese është më i madh dhe kësisoj përmbushin të dhënat për një parashtrësë filologjike. Janë marrë parasysh vepra të plota duke përjashtuar fragmentet e shkëputura nga këto botime. Dëshmitë e tekstit i kemi pajisur edhe me një sigël për lehtësi referimi.

#### ***Rasti Etëhem Haxhiademi***

Vepra e Etëhem Haxhiademit shfaqet si një rast tipik i thënies se jo çdo e keqe vjen për të bërë dëm. Ne kemi përzgjedhur tragjedinë *Skenderbeu*. Që nga botimi i parë më

1935<sup>1</sup> vepra ka njohur edhe 4 ribotime. Fakti që në hapësirën 1935-2020 nuk ka pasur ribotime të ndërmjetme brenda territorit shqiptar e ka mbrojtur këtë vepër nga manipulimi. Nga ana tjetër e dhëna që vepra është botuar në gjallje të autorit është shumë e rëndësishme për një filolog, për të pasur një bazë të mirë nisjeje për shqyrtim, krahasuar me botimet postume që përmbajnë gjithnjë në vetvete rrezikun e gabimit.

Megjithatë tragjedia njohu edhe botime të tjera jashtë territorit të Shqipërisë së sotme. Ernest Koliqi e boton atë në disa numra radhazi të revistës *Shêjzat* në Itali gjatë viteve 1968-1969<sup>2</sup> (S. 1968). Nga përjasja mes dy dëshmime të veprës na rezultojnë se kemi të bëjmë me një ribotim, i gjithi me shkronjë të pjerrët, që respekton origjinalin.

22 vite më pas, më 1990 në Kosovë, shtëpia botuese *Rilindja* e riboton tragjedinë së bashku me një tjetër tragjedi, *Abelin* (S. 1990)<sup>3</sup>. Kemi të bëjmë me një botim anastatik përgatitur nga Anton Pashku e Sabri Hamiti. Ndryshon vetëm faqja e vetëve (personazhet) si edhe numërtimi i faqeve. Mbetet jashtë analizës, përpos faktit që ka respektuar zgjedhjet autoriale.

Një tjetër botim i tragjedisë bëhet 10 vite më vonë, po në Kosovë, nga shtëpia botuese “Faik Konica (S. 2000)<sup>4</sup> si pjesë përbërëse e një përzgjedhjeje prej katër veprash dramatike.

<sup>1</sup> Etëhem Haxhiademi, *Skënderbeu* – Tragedi me pesë akte, Tiranë, Shtëpia botonjësë “Kristo Luarasi”, 1935. 84 faqe. Botuar në gjallje të autorit. (1900-1965).

<sup>2</sup> Akt’i parë, *Shêjzat*, (XII) 1968, n. 1-3, ff. 46-58.

Akt’i dytë, *Shêjzat*, (XII) 1968, n. 4-6, ff. 169-180.

Akt’i tretë, *Shêjzat*, (XIII) 1969, n. 7-9, ff. 362-374.

Akt’i katërtë, *Shêjzat*, (XIII) 1969, n. 10-12, ff. 460-470.

Akt’i pestë, *Shêjzat*, (XIII) 1969, n. 10-12, ff. 470-479.

<sup>3</sup> Etëhem Haxhiademi, *Dy tragjedi Abeli dhe Skënderbeu*, Prishtinë, Rilindja, 1990. Redaktorë Anton Pashku dhe Sabri Hamiti. ff. 91 – 178.

<sup>4</sup> Etëhem Haxhiademi, *Vepra 2 – Skënderbeu, Diomedë, Abeli, Lyra*, Prishtinë, Faik Konica, 2000. Redaktorë Nazmi Rrahmani dhe Hasan Hasani, ff. 7-87.

Redaktorët Nazmi Rrahmani dhe Hasan Hasani kanë sjellë një botim përgjithësisht të pastër.

Më 2020, vepra del e përfshirë e pesta në gjerdanin e botimeve, konceptuar nga Silvana Leka, të titulluar “Klasikët e letërsisë shqiptare (S. 2020)”<sup>5</sup>. Botimi është realizuar nga botimet POETIKA me redaktorë: Hortensia Haxhiademi Pëllumbi, Silvana Leka dhe si përgatitës botimi përforcohen me Arian Lekën. Një botim elegant, në të cilin ndërkallen mjaft riprodhime nga botimi origjinal i 1935, pasuruar edhe me citime nga kritika e kohës (vitet 1936-37), si në tekst të shtypur ashtu edhe në faksimile. Përgatitësit e këtij botimi këmbëngulin që në fillim të veprës se të gjitha veprat e Haxhiademit botohen sipas origjinalit, në publikimin e tyre të parë, dhe vepra jonë, vëllimi *Skënderbeu*, i përmbahet botimit të 1935. Vepra është shtypur e faqosur në një format gati anastatik, duke riprodhuar faqosjen e origjinalit: një zgjedhje e bukur kjo e përgatitësve për të përcjellë tek lexuesi ndjesitë e shfletimit të veprës në daljen e parë të saj, ashtu siç shihet edhe nga faksimilet e ndërkallura ndërmjet akteve e skenave të tragjedisë.

Kur marrim përsipër të realizojmë botime/ ribotime të një vepre duhet të jemi të kujdesshëm për të qëmtuar, në listën e dëshmive të tekstit, nëse kemi të bëjmë me një variant të autorit, me një variant të redaktorit, apo me një variant të transmetimit. Praktika e punës së botimeve në Shqipëri ka çaluar dukshëm për vite me radhë. Ardha e një pune serioze me tekstin, e kombinuar kjo me një vullnet të mirë për t’ia risjellë lexuesit të sotëm një tekst të shkruar 85 vite më parë, është e mirëpritur. Ndërkohë zhvillimet gjuhësore kanë bërë të vetën dhe arsimimi i brezave të rinj vetëm në standard ngre kurthe ku radhitësit mund të bien në mënyrë të pandërgjegjshme. Edhe njohja e gjuhës së autorit merr një rëndësi të veçantë pasi do të shmangte lexime të gabuara të

---

<sup>5</sup> Etëhem Haxhiademi, *Skënderbeu tragjedi me 5 akte*, Tiranë, Botimet POETIKA, 2020, 120 faqe.

tekstit: kjo gjë do ta shndërronte tekstin nga një variant të autorit në atë të redaktorit qoftë edhe për një fjalë të vetme. Konsultimi me fjalorë, enciklopedi a veprat e tjera të të njëjtit autor merr një rëndësi të dorës së parë.

### *Rasti Andon Zako Çajupi*

Vepra e Çajupit ka njohur një shumëllojshmëri botimesh kështu që ofron edhe mundësi më të mirë shqyrtimi. Fillimisht zgjedhja jonë ra mbi një tragjedi e cila ishte e ngjashme nga përmbajtja *Burri i dheut* (*Burr' i dheut*). Kemi mundur të shohim vetëm 3 botime të viteve 1977, 1983, 2001. Informacionet lidhur me dorëshkrimin e autorit dhe me punën që redaktorët a përgatitësit e botimit kanë bërë për botimin e tij janë të pakta e të pamjaftueshme për të qenë të besueshëm.

Në botimin e 1977<sup>6</sup> Floresha Haxhiaj saktëson: “Në vitin 1907 Çajupi kishte mbaruar tragjedinë në vargje *Burri i dheut*. Simbas dorëshkrimit (shënimi 1 = AQSH, Fondi Çajupi, Kutia 2, Dosja 6) tragjedisë i ishte vënë në fillim titulli *Skënderbeu Kastrioti* që u ndërrua pastaj në *Burri i dheut*.”<sup>7</sup> (BD. 1977, 16)

Më tej jepen të dhëna numerike: “Tragjedia “*Burri i dheut*” është ndërtuar në 5 akte (punë siç i quan autori), të përbëra prej 33 pamjesh”<sup>8</sup>. (BD. 1977, 17)

Në fund të parashtresës jepet një shënim në fund të faqes: “Në botimin e veprave të Çajupit zbatuam parimin e ruajtjes së gjuhës së autorit, duke bërë ato rregullime ortografike që lejon ritmi dhe numri i rrokjeve në vargje.”<sup>9</sup> (BD. 1977, 29). Asnjë e dhënë më shumë.

<sup>6</sup> A. Z. Çajupi, *Vepra dramatike* përgatitur për botim nga Floresha Haxhiaj, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1977, f. 135-303.

<sup>7</sup> *Po aty*, f. 16.

<sup>8</sup> *Po aty*, f. 17.

<sup>9</sup> *Po aty*, f. 29.

Botimi tjetër i 1883<sup>10</sup> (BD. 1983), i përgatitur po nga Floresha Dado (Haxhiraj) nuk ka asnjë parashtrësë hyrëse si i tillë nuk përmbush kriterin e transparencës dhe të gjurmueshmërisë.

I pamjaftueshëm dhe i pagjurmueshëm edhe shënimi i vetëm: “Kjo vepër botohet e plotë duke u mbështetur në botimet e mëparshme para çlirimit” që hasim në një ribotim të veprës letrare të Çajupit nga shtëpia Botuese “UEGEN” më 2001 (BD. 2001<sup>a</sup>)<sup>11</sup>.

Botime të tilla nuk ofrojnë asnjë garanci shkencore për saktësinë e tekstit dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë si bazë e sigurt për studime të mëtejshme.

### ***Botimi i komedisë “Pas vdekjesë”***

Po ç’fat ka pasur komedia “Pas vdekjesë” e cila ofron edhe dorëshkrimet e veprës, rast entuziazmues për një filolog. Botimet e marra në shqyrtim prej nesh janë:

A. Zako Çajup. *Pas vdekjes* Komédie, Kairo **1910**, Botim’i parë, Vënë në shtyp prej Sofokli Çapit<sup>12</sup> (PV. 1910)

A. Z. Çajupi, *Vepra dramatike* përgatitur për botim nga Floresha Haxhiaj (Dado), Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë **1977**, f. 81-134 (PV. 1977)

---

<sup>10</sup> Andon Zako Çajupi, *Vepra letrare II*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1983. F. 89-266. Përgatitur dhe redaktuar nga Floresha Dado.

<sup>11</sup> A. Z. Çajupi, *Vepra letrare*, Uegen, Tiranë 2001, f. 157-274. Redaktor Demir Gjergji.

<sup>12</sup> Komedia pas vdekjes pati fatin e shumicës së veprave të Çajupit, E hartuar në 1910 në Kajro, ajo nuk u botua në gjallje të autorit por disa vite pas vdekjes së tij. Në botimet e marra në shqyrtim studiuesit japin dy data të ndryshme për botimin e saj të parë në Shqipëri nga Sofokli Çapi: vitin 1935 (PV. 1977, 11) dhe 1937 (PV. 1978<sup>a</sup>, 61).

*Pas vdekjesë* Komodi e Shqipëruarë prej A. Zako (Çajup), Heliopolis (Egyt) botuar në *Studime filologjike* (Materiale e Dokumente) nr. 2, **1978**, f. 141-161. (PV. 1978)

Në të njëjtin numër të revistës botohet edhe artikulli i Jorgo Bulos, “Dorëshkrimi i komedisë *Pas vdekjes* të A. Z. Çajupit dhe disa probleme që lidhen me të” (PV. 1978<sup>a</sup>, f. 61- 68)<sup>13</sup>. Ky fakt na bën të kuptojmë që përgatitësi i botimit është Jorgo Bulo. Konfirmohet edhe në PV. 2001.

Andon Zako Çajupi, *Vepra letrare II*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë **1983**. F. 55-88. Përgatitur dhe redaktuar nga Floresha Dado. (PV. 1983)

A. Z. Çajupi, *Vepra dramaturgjike*, Dituria, Tiranë, 2001, f. 45-67. (PV. 2001) Redaktor Petrit Ymeri. Komedia dhe parashpresa nga Jorgo Bulo janë një rimarrje e PV. 1978 dhe PV. 1978<sup>a</sup>.

A. Z. Çajupi, *Vepra letrare*, Uegen, Tiranë **2001**, f. 275-296. Redaktor Demir Gjergji. (PV. 2001<sup>a</sup>)<sup>14</sup>

Nga krahasimi i teksteve na rezulton se botimet nuk ndjekin të njëjtën linjë transmetimi të tekstit, por arketipe të ndryshme kanë shërbyer si botim i parë bazë. Ka një varësi të dukshme dhe të drejtpërdrejtë të (PV. 1977) nga (PV. 1910)

(PV. 1910, 10)

“Adhamudhi : **As pak!...** Mor zot, pse dëm fjalët? **s’krren** dot fjalë nga unë!... S’pres nder nga njeri kurrë”... Lëvdata s’dua! **Si do** që të thonë, shëronjës si unë janë të rrallë: shëroj sy, veshë hundë, duar, këmbë! Ç’do sëmundje dridhet nga unë! Do të

<sup>13</sup> Jorgo Bulo: “Dorëshkrimi i komedisë *Pas vdekjes* të A. Z. Çajupit dhe disa probleme që lidhen me të”, në *Studime filologjike*, nr. 2, 1978, f. 63-68.

<sup>14</sup> Del në pah i njëjti problem: i pamjaftueshëm shënimi i vetëm “Kjo vepër botohet e plotë duke u mbështetur në botimet e mëparshme para çlirimit.” Nuk përmbush kriterin e transparencës dhe të gjurmueshmërisë.

thuash që s'kam shumë **“myshtërinj”**. Kurrë mos **arçin!** Le të vuajnë! Kush u ka faj?”

(PV. 1977, 90)

“Adhamudhi : **Aspak!...** Mor zot, pse dëm fjalët? **S'kërren** dot fjalë nga unë!... S'pres nder nga njeri kurrë”... Lëvdata s'dua! **Sido** që të thonë, shëronjës si unë janë të rrallë: shëroj sy, veshë hundë, duar, këmbë! **Çdo** sëmundje dridhet nga unë! Do të thuash që s'kam shumë **“myshtërinj”**. Kurrë mos **ardhshin!** Le të vuajnë! Kush u ka faj?”

Janë fare të qarta ndërhyrjet e pasinjalizuara të përgatitëses të botimit megjithëse ajo mëton se ka zbatuar “parimin e ruajtjes së gjuhës së autorit, duke bërë ato rregullime ortografike që lejon ritmi dhe numri i rrokjeve në vargje.” (BD. 1977, 29)

Po lejohej gjithsesi të sjell në vëmendjen tuaj faktin se pas mbajtjes së *Kongresit të Drejtshkkrimit* në vitin 1972 shtëpitë botuese kanë pasur si orientim, në mos të përcaktuar me rregullore, që të botonin veprat vetëm në variantin standard të shqipes. Botimi i veprave në variante më të hershme të shqipes u lejohej vetëm studiuesve të Akademisë së Shkencave. Ja një dëshmi e tërthortë lidhur me këtë fakt. Në vitin 25.3.1986, drejtori i shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, i shkruan Jup Kastratit, asokohe punonjës i Institutit e Lartë Pedagogjik në Shkodër:

“Sipas kritereve të miratuara kohët e fundit, shtëpia botuese “Naim Frashëri” do të botojë veprat e traditës të autorëve arbëresh vetëm në gjuhën e sotme. Botimet në dy gjuhë (në të vjetrën dhe atë të sotmen) do t'i bëjë Akademia e Shkencave.

Kështu që veprën “Skënderbeu i pafan”, që keni përshtatur ju nuk mund ta botojmë në dy variante.”<sup>15</sup>

Ndërsa si arketip i dytë ka shërbyer dorëshkrimi autograf i vetë Çajupit, të cilin Sofokli Çapi ia dhuroi Arkivit të Shtetit (Tiranë) në fundin e viteve '50. Është ky dorëshkrim i cili është sjellë në botim kritik nga Jorgo Bullo dhe botuar si hyrje studimore e si tekst në revistën *Studime filologjike* më 1978. Për këtë vepër postume dorëshkrim Jorgo Bullo:

- ndërton historikun e transmetimit
- jep përshkrimin e e zgjeruar të dorëshkrimit
- argumenton kur mund të jetë hartuar varianti i autorit mbi të cilin është mbështetur Sofokli Çapi në botimin e 1937

- arsyeton se dorëshkrimi i autorit që është depozituar në 1957 në AQSH përbën një variant të ripunuar nga Çajupi duke paraqitur tipologjitë e ndryshimeve

- dëshmon se merr në konsideratë fakte historike të ndodhura e të përmendura në komedi që e ndihmojnë për t'iu afruar kohës së hartimit apo rishikimit të veprës

- jep kriteret e transkriptimit.

Të gjitha këto të dhëna e ngjisin botimin e komedisë “Pas vdekjesë” (PV. 1978), në kurbën e varianteve të autorit, si vullneti i fundmë i tij, i cili duhet marrë në konsideratë si teksti që ofron garancinë shkencore mbi të cilin duhet të mbështeten studimet apo ribotimet e mëvonshme.

Ky botim ka shërbyer si bazë edhe për (PV. 2001).

Le ta ilustrojmë këtë:

(PV. 1978, 159)

“Prandaj kur u hap kjo lajm’ e zezë ndë qytet, gra e burra, djem e pleq, u hidhëruan, u pikëlluan dhe nukë mbeti asnjë pa

<sup>15</sup> Cituar sipas: *Jeronim De Rada*, Vepra historiko-filologjike kuruar nga prof. Jup Jastrati – in memoriam, Tiranë, QSPA 2020, f. 904. Nënvizimi është i letërshtuesit.

mos vajtur të shojë për herën e fundit, duke derdhur lot rrëke. Në një çast u mbush shtëpia me **njerës** e me kurorë lulesh....”

(PV. 1983, 84)

“Prandaj kur u hap kjo lajm’ e zezë ndë qytet, gra e burra, djem e pleq, u hidhëruan, u pikëlluan dhe nukë mbeti asnjë pa mos vajtur të shojë për herën e fundit, duke derdhur lot rrëke. Në një çast u mbush shtëpia me **njerëz** e me kurorë lulesh....”

(PV. 2001, 65)

“Prandaj kur u hap kjo lajm’ e zezë ndë qytet, gra e burra, djem e pleq, u hidhëruan, u pikëlluan dhe nukë mbeti asnjë pa mos vajtur të shojë për herën e fundit, duke derdhur lot rrëke. Në një çast u mbush shtëpia me **njerës** e me kurorë lulesh....”

(PV. 2001<sup>a</sup>)

“Prandaj kur u hap kjo lajm’ e zezë ndë qytet, gra e burra, djem e pleq, u hidhëruan, u pikëlluan dhe nukë mbeti asnjë pa mos vajtur të shojë për herën e fundit, duke derdhur lot rrëke. Në një çast u mbush shtëpia me **njerëz** e me kurorë lulesh....”

E dukshme varësia e (PV. 2001<sup>a</sup>) nga (PV. 1983), botime që nuk na ofrojnë burime të cituara nga janë marrë, po ashtu dhe varësia e (PV. 2001) nga (PV. 1978).

Në përfundim të këtij shqyrtimi filologjik të botimeve të ndryshme, për të dy autorët Haxhiademi e Çajupi, duam të theksojmë rolin parësor e të pazëvendësueshëm që kanë përgatitësit e botimeve, të cilët për të na dhënë një botim serioz e shkencërisht të referueshëm duhet të karakterizohen nga serioziteti, nga besnikëria dhe nga munda për të qenë transparent me lexuesit dhe gjurmëlënës për studiuesit që do të marrin në dorë punën e tyre të mëtejshme.

**BIBLIOGRAFI E SHQYRTUAR**

- Bulo, J., “Dorëshkrimi i komedisë *Pas vdekjes* të A. Z. Çajupit dhe disa probleme që lidhen me të” në *Studime filologjike*, nr. 2, 1978, f. 61- 68.
- Çajupi, A. Z., *Vepra dramatike*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977.
- Çajupi, A. Z., *Vepra letrare II*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1983.
- Çajupi, A. Z., *Vepra letrare*, Uegen, Tiranë, 2001.
- Çajup, A. Z., *Pas vdekjes*, Komédie, Kairo, 1910.
- Çajupi, A. Z., *Vepra dramaturgjike*, Dituria, Tiranë, 2001.
- De Rada, J., *Vepra historiko-filologjike*, kuruar nga prof. Jup Jastrati – in memoriam, botim i QSPA, Tiranë 2020.
- Haxhiademi, E., *Skenderbeu* – Tragedi me pesë akte, Shtëpia botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1935.
- Haxhiademi, E., *Dy tragjedi Abeli dhe Skënderbeu*, Prishtinë, Rilindja, 1990.
- Haxhiademi. E., *Vepra 2 – Skënderbeu, Diomedi, Abeli, Lyra*, Faik Konica, Prishtinë 2000.
- Haxhiademi, E., *Skënderbeu tragjedi me 5 akte*, Botimet POETIKA, Tiranë 2020.
- Pas vdekjesë*, Komodi e Shqipëruarë prej A. Zako (Çajup), Heliopolis (Egyt) botuar në *Studime filologjike* (Materiale e Dokumente) nr. 2, 1978, f. 141-161.